

SHOQËRIA CIVILE KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR ROLET, METODAT DHE PRAKTIKAT

FILLIP STOJANOVIQ



BCSP Belgrade Centre
for Security Policy

Shtator 2020

SHOQËRIA CIVILE KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR *ROLET, METODAT DHE PRAKTIKAT*

FILLIP STOJANOVIQ



Shtator 2020

SHOQËRIA CIVILE KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR: **ROLET, METODAT DHE PRAKTIKAT**

Botues

Qendra e Beogradit për Politikë të Sigurisë (BCSP)

Adresa: Đure Jakšića 6/5, Beograd, Serbi

Internet: www.bezbednost.org

Email: office@bezbednost.org

Autor

Fillip Stojanović

Redaktor

Sasha Gjorgjević

Recensent

Bojana Sellaković

Lekturimi

Allisa Kolenshić Radić

Design and Layout

Srdjan Ilić

Mohimi i përgjegjësisë

Mendimet e shprehura në këtë botim nuk përfaqësojnë mendimet e Ambasadës së Mbretërisë së Norvegjisë në Beograd, Fondit Ballkanik për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tyre.

Beograd, shtator 2020.

B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND



Norwegian Embassy
Belgrade

Botimi u mbështet financiarisht nga Fondi Ballkanik për Demokraci, projekti i Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe i Ambasadës së Mbretërisë së Norvegjisë në Beograd.

Përmbledhje

Shoqëria civile përfshin një larmi aktorësh, grupe, organizata joqeveritare dhe organizata në kuadër të bashkësisë, gazetarë hulumtues dhe anëtarë të grupeve të ekspertëve. Qëllimi i saj është të mbajë qeveritë të përgjegjshme përmes hulumtimit, përfaqësimit, mbrojtjes, mbështetjes ose mobilizimit të qytetarëve. Pasi që qeveritë dhe sistemet e drejtësisë penale mbështeten shumë në praktikën e kontrollit të krimit, shoqëria civile është një aktor i rëndësishëm dhe relevant në luftën kundër krimit të organizuar. Lufta më e mirë kundër krimit të organizuar kërkon një përqendrim të vëmendjes te viktimat dhe kryerësit, si dhe një vlerësim të përgjigjes institucionale (ku shoqëria civile mund të ndihmojë). Riorientimi i vëmendjes është veçanërisht i rëndësishëm për Gjashtëshen e Ballkanit Perëndimor, rajon transit për aktivitete të paligjshme, pjesët e së cilës aktualisht po përballen me prapësimin e demokracisë.

Korniza ligjore ndërkombëtare nuk e njeh në mënyrë adekuate rëndësinë e shoqërisë civile në luftën kundër krimit të organizuar dhe nuk parashikon përfshirjen e saj të plotë. Si pasojë, përpjekjet e shoqërisë civile për të bërë përpërim në luftën kundër krimit të organizuar dhe për të ndërtuar kanale të forta dhe të qëndrueshme të komunikimit për palët kryesore të interesit në sektorin publik dhe privat mbeten të diskutueshme. Prandaj, shoqëria civile është e përkushtuar të rishikojë kornizën ekzistuese legjislativë ndërkombëtare.

Shoqëria civile luan dy role kryesore në ballafaqimin me problemet e krimit të organizuar. Është shumë e dobishme në zbulimin e aktiviteteve të paligjshme të krimit të organizuar dhe mund të shërbejë si mbështetje për përpjekjet e drejtësisë penale dhe reformat në luftën kundër krimit të organizuar. Mirëpo, sfida qëndron në faktin se shumica e organizatave të shoqërisë civile janë të specializuara ose të përqendruara në një fushë specifike të krimit të organizuar. Ato gjithashtu varen nga situata në vend dhe disponueshmëria e fondeve të donatorëve. Nga ana tjetër, shoqëria civile mund të lidhë institucionet relevante dhe sektorin privat në luftën kundër krimit të organizuar.

Shoqëria civile ka në dispozicion pesë metoda: 1) monitorimin, vlerësimin ose hulumtimin e pavarur të rasteve specifike të krimit të organizuar, format e tij dhe reagimin institucional ndaj tyre, 2) ngritjen e vetëdijes publike dhe edukimin e qytetarëve për problemet në lidhje me krimin e organizuar, 3) ndihmën ose ofrimin e shërbimeve për individët e cenuar dhe grupet e rrezikut, 4) rrjetëzimin e palëve të interesuara relevante, dhe 5) angazhimin për zgjidhje ose mbajtje të presionit të vazhdueshëm mbi institucionet.

Hulumtimi dhe aktivitetet që përfshijnë hetimin e përgjigjeve institucionale ose raste specifike të krimit të organizuar janë identifikuar si disa nga shembujt më të mirë të përfshirjes së shoqërisë civile. Falë aktivizimit të shoqërisë civile, grupet e krimit të organizuar ndonjëherë gjykojnë në gjykatat kombëtare. Aktivitetet e bazuara në shërbime, të tilla si mbështetja e viktimave, janë veçanërisht të rëndësishme dhe të suksesshme. Krijimi i një rrjeti që përfshin aktivistë të shoqërisë civile, kriminologë nga komuniteti akademik dhe komuniteti lokal është një mekanizëm tjetër i rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar.

Aktivitetet kohezive të shoqërisë civile në nivelin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar janë elementët e nevojshëm për të bashkuar autoritetet, praktikuesit dhe aktivistët me qëllim të mirëqenies kulturore të shoqërisë. Organizatat e shoqërisë civile mund të kontribuojnë në reformën e mekanizmave aktualë institucionale për t'iu përgjigjur aktiviteteve të KO në të gjithë botën dhe të veprojnë si aktorë kulturorë, ekonomikë dhe socialë të ndryshimit në luftën kundër krimit të organizuar.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	5
LISTA E SHKURTESAVE	7
1. HYRJE	9
2. ROLET E SHOQËRISË CIVILE NË LUFTË KUNDËR KRIMIT	11
Kufizimet ligjore	11
Zbulimi i dëmit	12
Ndërtimi i urave	13
Sfidat dominuese	14
3. METODAT DHE PRAKTIKAT E SHOQËRISË CIVILE NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT	15
Hetimi	15
Ngritja e vetëdijes	16
Mbështetja	17
Rrjetëzimi	17
Përfaqësimi	18
4. KONKLUZION	20
5. REKOMANDIME	21
Shoqëria civile	21
Autoritetet e pushtetit kombëtar	21
Komuniteti ndërkombëtar	22
Sektori privat	22
BIBLIOGRAFIA	23

LISTA E SHKURTESAVE

ALAS	America Latina Alternativa Social
CHANCE	Qendra Civile kundër Krimit të Organizuar në Evropë
OShC	Organizatat e shoqërisë civile
EU	Bashkimi Evropian (BE)
GI-TOC	Nisma Globale kundër Krimit të Organizuar Transnacional
KO	Krimi i organizuar
GKO	Grupet e krimit të organizuar
SELEC	Qendra e Evropës Juglindore për Zbatim të Ligjit
SOCTA	Vlerësimi i Kërcënimit nga Krimet e Rënda dhe Krimi i Organizuar në BE
KB	Kombet e Bashkuara
UNCAC	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin
UNTOC	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional
UPR	Vlerësimi Periodik Universal
WB6	Gjashtëshja e Ballkanit Perëndimor

1. HYRJE

Gjashtëshja e Ballkanit Perëndimor (WB6) është një neologjizëm politik që përdoret për të përshkruar Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë Veriore, Malin e Zi dhe Serbinë në kontekstin e zgjerimit të Bashkimit Evropian (BE) me qëllim të përfshirjes së Evropës Lindore, zonës ku WB6 ndodhet gjeografikisht. Shumica e vendeve të WB6 kanë një histori të përbashkët, e cila ka rezultuar me probleme të zakonshme. Krimi i Organizuar (KO) është një nga sfidat më të mëdha, kjo e ilustruar me faktin se rajoni është i vendosur gjeografikisht midis Afganistanit, prodhuesit më të madh në botë të opiumit dhe Evropës Qendrore, tregut më të madh të heroinës në botë (UNODC, 2015).

Pas shpërbërjes së Jugosllavisë në vitet 1990, shumë nga problemet e brendshme që ekzistonin midis gjashtë ish republikave mbetën të pazgjidhura (Glenny, 2012, f. 634-706), pasuar nga “vitet e investimit të pamjaftueshëm, institucionet e dobësuara dhe mjedisi i pafavorshëm i biznesit” (Sanfey dhe Milatović, 2018). Si rezultat i të drejtave të pronës të mbrojtura në mënyrë joadekuate, mundësive lokale të punësimit dhe brishtësisë së shteteve, gjatë dy dekadave të para të shekullit 21, WB6 u bë tokë pjellore për krimin e organizuar (Dobovšek, 2006).

Vetë rajoni konsiderohet kryesisht si një zonë transiti për aktivitete të KO ose “kalim i KO kah Evropa” (Andreas, 2004, f. 48). Pasi që lidh korridoret e paligjshme të trafikut të Afganistanit me tregje të mëdha në Rusi dhe Evropën Qendrore (UNODC, 2014, f. 35), “Ruga Ballkanike” është një trajektore e rëndësishme, e përsosur për aktivitetet e grupeve kriminale në rajon. Grupet e Krimin të Organizuar (GKO) veprojnë përgjatë “Rugës Ballkanike” (UNODC, 2015, f. 17-21), ndërsa kryeqytetet, portet dhe pikat kufitare paraqesin “vatra” kryesore të aktiviteteve të tyre (GI-TOC, 2019, f. 8-27). Qendra e Evropës Juglindore për Zbatim të Ligjit (SELEC) vlerëson se GKO-të kanë kapacitet të rrjetëzohen, të angazhojnë anëtarë, të vendosin kontakte me furnizuesit dhe prodhuesit në vendet e origjinës dhe të zhvillojnë mjete të sofistikuar për të kryer aktivitete të paligjshme të KO (SELEC, 2018).

Mungesa e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe kontrollit të shteteve dhe shoqërisë civile në WB6 është një nga arsyet kryesore për aktivitetin e zhvilluar të KO (Buscaglia dhe Van Dijk, 2003). Korrupsioni sistemik - një formë e marrëdhënies së përbashkët të biznesit midis strukturave shtetërore dhe grupeve kriminale - e komplikon më tej luftën kundër KO në rajon. UNODC (2013, f. 7) thekson se korrupsioni ka një ndikim të madh në aktivitetet e KO në WB6. Edhe pse lufta kundër KO është një nga prioritetet kryesore të qeverive kombëtare të WB6, organizatat e shoqërisë civile (OSHC)¹ përdoren shumë pak si partnerë në atë luftë.

Qëllimi i këtij studimi është të identifikojë, shpjegojë dhe shtjellojë rolet, funksionet dhe praktikatat e OSHC-ve në luftën kundër KO në nivelet globale, rajonale dhe lokale. Studimi synon gjithashtu të informojë palët e interesuara kombëtare dhe rajonale të interesit se si dhe pse përfshirja e OSHC-ve në luftën kundër KO mund të bëjë një ndryshim, ndërsa paraqet përfitimet e një qasjeje të tillë për të gjithë aktorët përkatës. Qëllimi kryesor i studimit është të paraqesë modalitetet e angazhimit të shoqërisë civile në luftën kundër

¹ Organizatat e shoqërisë civile shpesh referohen si “sektori i tretë”, “sektori social” ose “vendi i vullnetarëve”. Ato përfshijnë një varg aktorësh, qëllimesh, grupe, media dhe organizata joqeveritare që synojnë t’i mbajnë qeveritë të përgjegjshme përmes hulumtimit dhe përfaqësimit, të promovojnë transparencën, të mbrojnë të drejtat e njeriut ose të mobilizojnë angazhimin e qytetarëve.

KO dhe të inkurajojë përpjekjet plotësuese në WB6. Është konceptuar si një hap fillestar në hulumtimin e luftës ekzistuese kundër KO dhe aktiviteteve të OShC-ve në WB6, dhe në vitin 2020 do të zbatohet nga Platforma Ballkanike e Sigurisë.²

Metodologjia përfshinte hulumtimin në tavolinë dhe pesë intervista me përfaqësuesit e OShC-ve dhe me ekspertët që monitoronin aktivitetet e KO. Hulumtimi në tavolinë përfshinte artikuj mjaft të rëndësishëm akademik të botuar në revistat më të cituara ndërkombëtare, ndërsa burimet dytësore përfshinin dokumentet e Kombeve të Bashkuara (KB), raporte nga organizata të tjera ndërkombëtare, studime, dokumente politikash dhe faqe zyrtare të OShC-ve që merren me forma të ndryshme të KO.

Hulumtimi në tavolinë u plotësua me pesë intervista në internet (tri përmes Skype dhe dy përmes postës elektronike). Intervistat u bazuan në një pyetësor gjysmë të strukturuar që mbulonte tri fusha kryesore: 1) profilin e një OShC-je të caktuar, 2) bashkëpunimin midis OShC-ve dhe autoriteteve zyrtare në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe 3) sfidat me të cilat përballen OShC-të në trajtimin e problemeve të KO. Disa pyetje kishin një ose më shumë nënseksione, të cilat u përdoren vetëm nëse i anketuari nuk arrinte të përgjigjej plotësisht në pyetjen kryesore.

Intervistat me Skype u kryen me Uglješa Zvekić (Këshilltar i Lartë në GI-TOC),³ Fabian Zhilla (Ekspert i fushës së KO nga GI-TOC)⁴ dhe Giulia Baruzzo (Zyrtare e Lartë e Departamentit Ndërkombëtar të LIBERA)⁵. Intervistat me postë elektronike u zhvilluan me Tejal Jesrani (Hulumtues në UNODC, pikëpamjet e të cilit që paraqiten në këtë studim nuk pasqyrojnë pikëpamjet e Kombeve të Bashkuara ose UNODC)⁶ dhe Lucas Manjon (Përfaqësues i ALAS)⁷.

Studimi përbëhet nga pesë kapituj. Kapitulli i parë, i cili pason hyrjen, merret me rolet kryesore të OShC-ve në zgjidhjen e problemeve të KO. Seksioni i mëposhtëm përshkruan pesë metodat kryesore të përdorura nga OShC-të në luftën kundër krimit, duke përfshirë praktikën dhe konkluzionet më të mira. Rekomandimet prezantohen në fund të studimit.

2 Platforma Ballkanike e Sigurisë (BSP) është rrjet i shoqërisë civile nga WB6 i specializuar në çështjet e sigurisë. Partnerët aktualë të BSP kanë bashkëpunuar për gati një dekadë. Aty përfshihen: 1) Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) - Shqipëri, 2) Qendra për Studime të Sigurisë (CSS) - Bosnjë dhe Hercegovinë, 3) Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (KCSS) - Kosovë, 4) Instituti i Alternativave - Mali i Zi, 5) Eurothink - Qendra për Strategji Evropiane - Maqedoni Veriore, dhe 6) Qendra e Beogradit për Politikë të Sigurisë (BCSP) – Serbi.

3 Nisma Globale kundër Krimit të Organizuar Transnacional (GI-TOC) ka siguruar një platformë për të promovuar më shumë debate dhe qasje inovative si gur themeli i një strategjie gjithëpërfshirëse globale kundër krimit të organizuar. Faqja zyrtare e internetit: <https://globalinitiative.net/>

4 Po aty.

5 LIBERA është një shoqatë italiane që promovon aktivitete në terren dhe lloje të ndryshme protestash kundër mafisë, krimit të organizuar në Itali dhe krimit të organizuar në përgjithësi. Faqja zyrtare e internetit: <https://www.libera.it/>

6 Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC) është një agjenci e Kombeve të Bashkuara e përkushtuar në arritjen e shëndetit, sigurisë dhe drejtësisë për të gjithë duke luftuar këto probleme dhe duke promovuar paqen dhe prosperitetin e qëndrueshëm përkundër tyre. Faqja zyrtare e internetit: <https://www.unodc.org/>

7 América Latina Alternativa Social (ALAS) është një rrjet i shoqërisë civile kushtuar promovimit të drejtësisë sociale, paqes, luftimit të abuzimeve të të drejtave të njeriut, mosndëshkueshmërisë dhe krimit të organizuar në Amerikën Latine. Faqja zyrtare e internetit: <http://www.red-alas.net/>

2. roLET E shoqërisë CIVILE në luftË kundër krimit

Kufizimet ligjore

Korniza ligjore ndërkombëtare nuk e njeh në mënyrë adekuate rëndësinë e OShC-ve në luftën kundër KO. Dokumentet më të rëndësishme ligjore ndërkombëtare në lidhje me luftën kundër KO dhe korrupsionit - Konventa e OKB-së e viti 2003 kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (UNTOC) dhe Konventa e KB e vitit 2005 e KB kundër Korrupsionit (UNCAC) - nuk përmendin instrumentet e hollësishme për veprimin e OShC-ve kundër KO; por njohin OShC-të si aktorë në luftën kundër KO.⁸ Për më tepër, Vendimi Kornizë i Këshillit Evropian i vitit 2008 për Luftimin e Krimit të Organizuar nuk përmban ndonjë dispozitë në lidhje me rolin e shoqërisë civile në luftën kundër KO. Kjo lë hapësirë për qeveritë të jenë fleksibile dhe të afta t'i përgjigjen shpejt tregjeve që ndryshojnë në kontekstin e aktiviteteve të paligjshme të KO.⁹

Zvekić (GI-TOC, 2018) shpjegoi se në të dy konventat, UNTOC dhe UNCAC, ekziston një pritje që shoqëria civile do të angazhohet në parandalimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, por nuk parashikohet përfshirja e plotë e shoqërisë civile në procesin e vlerësimit. Kontradikta është e dukshme.

Mungesa e një kornize ligjore të përshtatshme ndërkombëtare për angazhimin e OShC-ve kundër KO nuk është problem më vete; megjithatë, pa një përkufizim standard të roleve dhe funksioneve të OShC-ve në luftën kundër KO dhe një kuptim të përbashkët të asaj që përfaqëson KO në nivelin global (Finckenauer, 2005), përpjekjet për të bërë përparim në luftën kundër KO dhe për të ndërtuar kanale të qëndrueshme të koordinimit dhe komunikimit midis aktorëve të ndryshëm në luftën kundër KO në nivelet rajonale dhe kombëtare kanë tendencë të bëhen të diskutueshme.

Situata e përshkruar më sipër e ka detyruar shoqërinë civile të angazhohet për një rishikim të kornizës ekzistuese legjislative ndërkombëtare në lidhje me përkufizimin e KO dhe rolin e OShC-ve. Disa kritikë madje i quajnë këto konventa “shpallje ideologjike” sepse ato nuk parashikojnë dispozita legjislative ose mekanizma për të lejuar shoqërinë civile të veprojnë kundër KO, dhe për këtë arsye janë vetëm një “shkronjë e vdekur në letër” kur bëhet fjalë për rolin e OShC-ve në luftën kundër KO (GI-TOC, 2018).

“Një nga propozimet tona [LIBERA] është një platformë e re, e ngritur nga Komisioni Evropian dhe OShC-të që merren me këto çështje, të tilla si ajo që ekziston tashmë për trafikun e drogës”.¹⁰

8 Më saktësisht, ka vetëm disa artikuj në konventat dhe protokollet e KB që përmendin shoqërinë civile në kontekstin e rolit të saj të rëndësishëm në luftën kundër KO: neni 6 (f. 44), neni 9 (f. 46), neni 10 (f. 47), neni 14 (f. 61) (UNODC 2004a).

9 Tejal Jesrani (Hulumtues në UNODC), intervistë e kryer më 28 prill 2020. Pikëpamjet e bashkëbiseduesve nuk pasqyrojnë pikëpamjet e Kombeve të Bashkuara ose UNODC.

10 Giulia Baruzzo (Zyrtare e Lartë në Departamentin Ndërkombëtar të LIBERA, Romë), intervistë e kryer më 16 prill 2020.

Për shembull, agjenda politike e Qendrës Civile për Krimin e Organizuar në Evropë (CHANCE) bëri thirrje kohët e fundit (2019, f. 4) për të zëvendësuar Vendimin Kornizë të Këshillit Evropian të vitit 2008 me një të ri, i cili “do të merrte parasysh zhvillimet e reja në shoqëri dhe praktikën gjyqësore, në përputhje me përkufizimin e ri të përbashkët të fenomenit”. Përveç nevojës për të përcaktuar KO, iniciativa CHANCE gjithashtu thekson nevojën për të forcuar bashkëpunimin midis shteteve anëtare, institucioneve dhe agjencive evropiane, si dhe për të përfshirë sektorin privat dhe shoqërinë civile në luftën kundër KO. Një rekomandim tjetër nga agjenda politike është bashkëpunimi i drejtpërdrejtë midis shoqërisë civile dhe institucioneve të BE-së në luftën kundër KO:

- Krijimi i një forumi të përhershëm të shoqërisë civile mbi krimin e organizuar, midis Komisionit Evropian dhe Shoqërisë Civile Evropiane, siç është ai tashmë i vendosur dhe lidhur me politikat e luftës kundër trafikimit të drogës;
- Forcimi i Komisionit CRIM të Parlamentit Evropian si organ mbikëqyrës për zbatimin e legjislacionit relevant dhe promovimin e një strategjie të integruar dhe globale kundër sistemeve kriminale dhe aktiviteteve të ndërlidhura të tilla si korrupsioni dhe pastrimi i parave;
- Krijimi i observatorëve kombëtarë për krimin e organizuar, të cilat do të promovojnë shoqërinë civile në bashkëpunim me institucionet akademike dhe organet publike dhe të cilat do të inkurajojnë trajnimin e operatorëve të specializuar në luftën kundër krimit, korrupsionit dhe pastrimit të parave (CHANCE, 2019, f. 4).

Nevoja për të rishikuar kornizën legjislativë dhe kontekstin e KO është shkaktuar nga natyra e KO që ka ndryshuar me kalimin e kohës dhe inkurajohet nga përvoja e gjerë e OShC-ve të përfshira në monitorimin e aktiviteteve të paligjshme të KO.¹¹

Zbulimi i dëmit

Shoqëria civile (veçanërisht gazetarët hulumtues) është shumë e dobishme në zbulimin e aktiviteteve të paligjshme të KO dhe mund të shërbejë për të mbështetur përpjekjet dhe reformat e drejtësisë penale në luftën kundër KO. Mirëpo, në fushën e luftës kundër KO, shumica e OShC-ve specializohen vetëm në një fushë specifike të krimit të organizuar. Ato varen gjithashtu nga situata në vend dhe disponueshmëria e fondeve të donatorëve. Kjo çon në një qasje të pjesshme të shoqërisë civile ndaj krimit të organizuar, ku një numër i vogël i grupeve janë në gjendje të përcjellin mesazhe në lidhje me krimin e organizuar *si tërësi*.¹²

“Pjesëtarët e OShC-ve janë njerëz që mund të sjellin ndryshime, të zbulojnë sjellje të keqe dhe të përcaktojnë atë që është e mirë.”¹³ Shumë ekspertë në fushën e krimit të organizuar pajtohen se mungesa e komponentit të shoqërisë civile ishte faktor shumë i rëndësishëm në shfaqjen dhe funksionimin e mafisë në Itali. Shfaqja e dhunës dhe vrasjet e gjyqtarëve dhe prokurorëve italianë nga mafia gjatë viteve 1980 dhe 1990 u shënuan si fillimi i tërheqjes së saj graduale (Picarelli, 2008, f. 491), me

11 Giulia Baruzzo (Zyrtare e Lartë në Departamentin Ndërkombëtar të LIBERA, Romë), intervistë e kryer më 16 prill 2020.

12 Tejal Jesrani (Hulumtues në UNODC), intervistë e kryer më 28 prill 2020. Pikëpamjet e bashkëbiseduesve nuk pasqyrojnë pikëpamjet e Kombeve të Bashkuara ose UNODC.

13 Fabian Zhilla (Ekspert i Krimit të Organizuar në GI-TOC), intervistë e kryer më 10 prill 2020.

çka u la më shumë hapësirë për manovra të OShC-ve dhe forcimin e marrëdhënieve të tyre me mekanizmat e tjerë të kontrollit që u përdorën për të parandaluar aktivitetet e paligjshme të KO”.

Nevojitet një qasje gjithëpërfshirëse për KO nëse OShC-të do të fitojnë ndikim më të madh për të gjitha çështjet përkatëse që lidhen me KO. Në nivelin kombëtar, ato duhet të kenë parasysh se lufta kundër KO nuk është prioritet në kohën kur shtetet merren me çështjet e tyre të sigurisë. Me fjalë të tjera, në vitet e fundit, lufta kundër KO - veçanërisht korrupsioni dhe pastrimi i parave - nuk ka qenë prioritet kryesor as për institucionet kombëtare dhe as për ato evropiane sepse të dyja, si vendet veç e veç ashtu edhe BE-ja, i kanë konsideruar si çështje më të rëndësishme ato siç janë terrorizmi, migracioni i paligjshëm, radikalizimi dhe trafikimi i qenieve njerëzore. Në këtë kontekst, OShC-të kanë mundësinë të krijojnë një agjendë të sigurisë kombëtare përtej këtyre çështjeve të sigurisë globale dhe të përqendrohen në çështje me interes real lokal siç janë korrupsioni dhe pastrimi i parave.¹⁴ Një nga arsytet e kësaj situatë është natyra në ndryshim e KO, ku forma të caktuara më pak të dukshme dhe më delikate kanë zëvendësuar llojet e mëparshme të dhunshme të KO që më parë tërhoqën vëmendjen e autoriteteve kombëtare. Ky proces i ndryshimit të natyrës së KO quhet “krizë e identitetit” të KO.¹⁵ Prandaj, kuptimi i kontekstit në të cilin ndodhin format delikate të KO është gjithashtu me një rëndësi të madhe.

Ndërtimi i urave

Shoqëria civile mund të lidhë institucionet relevante dhe sektorin privat në luftën kundër KO. Interesi i ndërmarrjeve përqendrohet në zvogëlimin e pasojave të KO dhe eliminimin e tij nga tregu i lirë, ku ai zë hapësirën e nevojshme për aktivitetet (ligjore) të vet ndërmarrjeve.¹⁶ Profiti mund të shihet si motivi themelor për përfshirjen e sektorit privat në luftën kundër KO. Në këtë kontekst, bashkëpunimi midis OShC-ve, autoriteteve kombëtare dhe sektorit privat mund të arrihet duke përdorur metoda përkatëse të OShC-ve të tilla si angazhimi për nevojën e përfshirjes së sektorit privat, rrjetëzimi i aktorëve kryesorë dhe ngritja e vetëdijes publike për natyrën e përgjithshme të dëmshme të aktiviteteve të KO. Natyrisht, suksesi i këtij bashkëpunimi do të varet kryesisht nga profili i hulmtuesve specifik dhe OShC-ve, reputacioni dhe niveli i tyre i profesionalizmit, metodologjia e përdorur dhe fenomenet që studiohen,¹⁷ si dhe shkalla e demokratizimit të një shteti të caktuar,¹⁸ gjë që do ta bënte specifik këtë rast bashkëpunimi rast pas rasti.

“OShC-të duhet të ndërtojnë ura me institucionet politikëbërëse.”¹⁹

Përveç që shihen si instrument për ndërtimin e urave midis autoriteteve kombëtare dhe kompanive private, OShC-të konsiderohen gjithashtu faktor i rëndësishëm mbështetës kur bëhet fjalë për parandalimin dhe luftimin e aktiviteteve të paligjshme të KO në

14 Giulia Baruzzo (Zyrtare e Lartë në Departamentin Ndërkombëtar të LIBERA, Romë), intervistë e kryer më 16 prill 2020.

15 Tejal Jesrani (Hulmtues në UNODC), intervistë e kryer më 28 prill 2020. Pikëpamjet e bashkëbiseduesve nuk pasqyrojnë pikëpamjet e Kombeve të Bashkuara ose UNODC.

16 Fabian Zhilla (Ekspert i Krimit të Organizuar në GI-TOC), intervistë e kryer më 10 prill 2020.

17 Tejal Jesrani (Hulmtues në UNODC), intervistë e kryer më 28 prill 2020. Pikëpamjet e bashkëbiseduesve nuk pasqyrojnë pikëpamjet e Kombeve të Bashkuara ose UNODC.

18 Uglješa Zvekić (Këshilltar i Lartë në GI-TOC, Romë), intervistë e kryer më 6 prill 2020.

19 Fabian Zhilla (Ekspert i Krimit të Organizuar në GI-TOC), intervistë e kryer më 10 prill 2020.

bashkëpunim me shtetin. Me fjalë të tjera, OShC-të kanë jo vetëm rol ndërmjetësues në lidhjen e palëve të ndryshme të interesit, por edhe rol aktiv në drejtim të bashkëpunimit me institucionet shtetërore. Forma më e zakonshme e angazhimit aktiv të OShC-ve është ofrimi i mbështetjes për viktimat e krimit në fusha të ndryshme - nga ofrimi i këshillave ligjore dhe mbështetja sociale, deri te sigurimi i strehimit dhe sigurisë për viktimat e trafikimit. Prandaj, “ndërtimi i urave” kërkon që OShC-të jo vetëm të kenë vullnetin për të luftuar kundër aktiviteteve të KO, por gjithashtu që institucionet shtetërore të jenë të gatshme të njohin këtë rol të rëndësishëm të OShC-ve.

Sfidat dominuese

Organizatave të shoqërisë civile përballen me sfida në luftën kundër KO pasi nuk janë të gjitha njësoj për sa i përket zhvillimit, reputacionit dhe cilësisë së punës. Prandaj, ato kanë ndikime të ndryshme mbi qeveritë dhe autoritetet. Ky problem nuk është unik vetëm për WB6. Bashkëbiseduesi nga GI-TOC deklaroi se në nivelin ndërkombëtar, d.m.th. në nivelin e KB, ka një ndarje të dukshme midis (disa) vendeve që janë të interesuara të luftojnë KO dhe që kanë një qëndrim pozitiv ndaj OShC-ve të angazhuara në këtë fushë dhe të tjerëve që nuk përfshijnë OShC-të në aktivitete të tilla.²⁰

Çështjet e sigurisë janë një sfidë për shumë aktivistë dhe organizata të shoqërisë civile. Situata e mësipërme bëhet edhe më e dukshme në kontekstin e sulmeve ndaj OShC-ve, veçanërisht kur bëhet fjalë për KO që në vetvete është një temë shumë e ndjeshme. OShC-të kanë një pozicion specifik në WB6. Qëndrimi negativ i autoriteteve ndaj këtyre organizatave, shpesh lidhet me mosbesimin e qeverisë dhe qytetarëve (BCSDN, 2019) që shpie në pjesëmarrje të pamjaftueshme të OShC-ve në luftën kundër KO. Qëndrimi i tyre më shumë se kritik ndaj qeverisë dhe autoriteteve kombëtare mund të jetë gjithashtu një nga faktorët domethënës që i ka sjellë në pozitë të pafavorshme. Ndarja e mediave në ato që favorizojnë dhe ato që kundërshtojnë punën e disa OShC-ve, si dhe polarizimi i thellë i shoqërisë në këtë kontekst, gjithashtu ka kontribuar në pozitën komplekse të disa OShC-ve në shoqëri.

Këta faktorë, të kombinuar me mungesën e transparencës, frikës dhe rreziqeve,²¹ kanë çuar në një përkeqësim të pozitës së OShC-ve në luftën kundër KO, që, në shumicën e rasteve, rezulton në rolin e tyre dytësor. Prandaj, problemi është më sistematik. Me fjalë të tjera, pa mbështetjen e shtetit në zhvillimin e shoqërisë civile dhe organizatave të saj, nuk është e mundur të përfshihen OShC-të në shumë aspekte të jetës shoqërore. Një prej tyre është lufta kundër KO.

²⁰ Po aty.

²¹ Fabian Zhilla (Ekspert i Krimit të Organizuar në GI-TOC), intervistë e kryer më 10 prill 2020.

3. METODAT DHE PRAKTIKAT E SHOQËRISË CIVILE NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT

Metodat e shoqërisë civile për zgjidhjen e problemeve të KO janë: 1) monitorimi, vlerësimi ose hulumtimi i pavarur i rasteve specifike të KO, format e KO dhe reagimi institucional ndaj tyre, 2) ngritja e vetëdijes publike dhe edukimi i qytetarëve për problemet e shkaktuara nga KO, 3) ndihma ose ofrimi i shërbimeve për individë dhe grupe që janë të cenuara ose në rrezik, 4) rrjetëzimi i palëve të interesuara relevante që luftojnë KO, dhe 5) angazhimi për zgjidhje në luftën kundër KO ose mbajtja e presionit të vazhdueshëm mbi institucionet.

Hetimi

Aktivitetet hetimore dhe hulumtuese në lidhje me përgjigjet institucionale ose raste specifike dhe forma të KO - trafikimi i drogës ose qenieve njerëzore, trafikimi i paligjshëm i armëve ose dhuna e GKO - janë identifikuar si shembuj të mirë të metodave aktive dhe të dukshme të shoqërisë civile në zgjidhjen e problemit të krimit të organizuar.²² Konkretisht, aktivizmi i theksuar i OShC-ve dhe gazetarëve hulumtues në zbulimin e lidhjes midis KO dhe shtresave më të larta politike dhe pranisë së përfaqësuesve të tyre në media konsiderohen disa nga praktikat më të dukshme dhe më të zëshme në luftën kundër KO.

Për dallim nga gazetaria hulumtuese, e cila mbështetet në fakte dhe prova për të zbuluar të vërtetën, hulumtimi mbi forma specifike të KO sendërtohet mbi një njohuri më gjithëpërfshirëse dhe bazohet kryesisht në literaturë, baza të dhënash dhe intervista me ekspertë relevantë. Përdorimi i sasive jashtëzakonisht të mëdha të të dhënave dhe informatave në dispozicion të publikut kontribuon në kapacitetin e OShC-ve për të zbuluar forma të KO në rastet nën hetim, duke bërë kështu presion mbi qeveritë për të vepruar.²³

“Është e pamundur të luftohet diçka që nuk mund ta shihet. Sasia aktuale e të dhënave dhe analizave të krimit të organizuar fsheh praninë e përgjithshme të tij pas formave të tjera të krimit.”²⁴

Megjithatë, metodat e hulumtimit dhe hetimit janë të vështira për t'u zbatuar në WB6 për shkak të mungesës së transparencës së qeverive. Janë ndërmarrë disa hapa pozitivë drejt arritjes së qasjes së hapur, por procesi është në një nivel të palakmueshëm dhe akoma shumë i ngadaltë (UNODC, 2017). Një problem tjetër qëndron në menaxhimin statistikor të rasteve të KO në sistemet e drejtësisë penale dhe ndikimin e tyre në kuptimin e vetë fenomenit.²⁵ Për shembull, në Serbi, është e vështirë të monitorohen gjykimet përmes sistemit policia-prokuroria-gjykata për shkak të bazave të ndryshme të të dhënave të përdorura. Ky problem ekziston gjithashtu në nivelin rajonal ku mungon një metodologji e konsoliduar për mbledhjen e të dhënave, ruajtjen dhe raportimin e të dhënave. Ekzistojnë gjithashtu rreziqe të sigurisë për hulumtuesit dhe gazetarët, veçanërisht në

22 Uglješa Zvekić (Këshilltar i Lartë në GI-TOC, Romë), intervistë e kryer më 6 prill 2020.

23 Tejal Jesrani (Hulumtues në UNODC), intervistë e kryer më 28 prill 2020. Pikëpamjet e bashkëbiseduesve nuk pasqyrojnë pikëpamjet e Kombeve të Bashkuara ose UNODC.

24 Po aty.

25 Po aty.

vendet me demokraci dhe shoqëri të pazhvilluara që kanë qëndrim negativ ndaj OShC-ve të caktuara - zakonisht atyre që janë më të zëshme kur bëhet fjalë për kritika. Në këtë kontekst, kërcënimet ndaj hulumtuesve dhe gazetarëve të KO nuk janë të rralla.²⁶

Gjykimet e krimit të organizuar janë një tjetër pasojë e aktiviteteve të OShC-ve në luftën kundër KO. Për shembull, OShC-të si LIBERA ose ALAS mund të mburren me një numër të lakmueshëm të çështjeve të KO që kanë çuar në gjykatë. Megjithëse LIBERA kishte më shumë se 25 raste të tilla, ALAS zhvilloi gati 400 hetime gjyqësore.²⁷ Megjithëse këto gjykime mund të zgjasin disa vjet, ato janë shembuj të mirë të aktivizmit të OShC-ve që janë materializuar në praktikën e luftës kundër KO.

Një shembull tjetër i mirë i ndikimit të shoqërisë civile lidhet me rrugën që një person ka kaluar nga hulumtuesi deri në vendimmarrje. Me fjalë të tjera, dy hulumtues shqiptarë botuan një studim për KO (Zhilla, Lamallari, 2017). Bashkëbiseduesi thotë se, pasi përfundoi studimi, një nga autorët - Besfort Lamallari - u ftua të bëhej Zëvendës Ministër i Brendshëm i Shqipërisë. Për të, kjo ishte një mundësi për të zbatuar dhe mbrojtur disa nga rekomandimet dhe për të përmirësuar marrëdhëniet midis qeverisë dhe shoqërisë civile, dhe ai e shfrytëzoi atë mundësi.²⁸

Ngritja e vetëdijes

Metoda hetimore është më efektive nëse ka të bëjë me zbulimin e pasojave negative të veprimtarive të paligjshme të KO dhe dëmet që ato i shkaktojnë shoqërisë. Kuptimi i 'ngritjes së vetëdijes' si proces që synon informimin dhe edukimin e njerëzve në lidhje me KO, aktorët e ngritjes së vetëdijes duhet të jenë të pranishëm gjithkrah dhe vazhdimisht të përkushtuar në zbulimin e aktiviteteve të paligjshme të KO. Një nga shembujt aktualë të ngritjes së vetëdijes në Serbi u zhvillua nga organizata hetimore Rrjeti për Raportimin e Krimit dhe Korrupsionit (KRIK). Përmes pranisë në mediat konvencionale dhe sociale, aktivitetet e tyre hetimore padyshim që rrisin vetëdijen e publikut për ekzistencën e KO në WB6 përveç zbulimit të aktiviteteve kriminale dhe lidhjes së tyre me autoritetet shtetërore. Në disa histori të fundit hulumtuese, gazetarët e KRIK-ut kanë treguar se si aktivitetet e KO në WB6 çojnë në pasoja negative si korrupsioni, ndjenjat e pasigurisë, mungesa e demokracisë, trazirat shoqërore dhe mosbesimi ndaj autoriteteve shtetërore.²⁹

Një shembull tjetër i mirë i ngritjes së vetëdijes së publikut janë të ashtuquajturat iniciativa antimafia që ndikojnë në jetën e përditshme të qytetarëve evropianë. Për shembull, organizata italiane e shoqërisë civile shton në produkte etiketën antimafia (Burkett, 2009) dhe 'Mafia? Jo, faleminderit!' Iniciativa në Gjermani (Scarabelli, 2013) inkurajon ndërmarrësit e vegjël të refuzojnë çdo kërcënim mafioz dhe të ngrenë zërin

26 Fabian Zhilla (Ekspert i Krimit të Organizuar në GI-TOC), intervistë e kryer më 10 prill 2020; Lucas Manjon (Përfaqësues i ALAS, Buenos Aires), intervistë e kryer më 29 prill 2020.

27 Giulia Baruzzo (Zyrtare e Lartë në Departamentin Ndërkombëtar të LIBERA, Romë), intervistë e kryer më 16 prill 2020; Lucas Manjon (Përfaqësues i ALAS, Buenos Aires), intervistë e kryer më 29 prill 2020.

28 Fabian Zhilla (Ekspert i Krimit të Organizuar në GI-TOC), intervistë e kryer më 10 prill 2020.

29 Rrjeti i Raportimit të Krimit dhe Korrupsionit (KRIK) është një organizatë jofitimprurëse e krijuar për të promovuar gazetarinë hulumtuese në Serbi. Organizata u themelua nga një ekip gazetarësh që kanë punuar për të zbuluar krimin dhe korrupsionin për vite me radhë dhe të cilët kanë marrë shumë çmime për punën e tyre. Faqja zyrtare e internetit: <https://www.krik.rs/en/>

dhe deklaratat e tyre se nuk kanë asnjë lidhje me KO. Megjithatë, edhe pse këto aktivitete afatshkurtra të projektit janë shembuj të mirë për ngritjen e vetëdijes së publikut, duhet kuptuar që vetëm ngritja e vazhdueshme e vetëdijes mund të prodhojë efekte afatgjata në luftën kundër KO.

Mbështetja

Aktivitetet e bazuara në shërbime janë treguar të jenë veçanërisht të rëndësishme dhe të suksesshme në zbutjen e dëmit të shkaktuar nga aktivitetet e paligjshme të KO. Ofruesit e shërbimeve që punojnë me komunitetet lokale për të rehabilituar dhe integruar të rinjtë e ekspozuar ndaj KO (të tillë si OShC-të që punojnë me viktimat e trafikimit dhe migrantët ose ata që ofrojnë ndihmë për parandalimin e trafikimit të drogës, ndihmë për të burgosurit, etj.) luajnë një rol shumë të rëndësishëm dhe të dukshëm.³⁰ Bashkëbiseduesi ynë theksoi se OShC-të që ofrojnë lloje të ndryshme të shërbimeve janë zakonisht më neutrale. Ata nuk kanë një 'uniformë ideologjike' dhe prandaj i pranojnë donatorët më lehtë.³¹

"Besoj se mënyra më e mirë për të pasur një kombinim të drejtë të aktivizmit shoqëror dhe hulumtimit është krijimi i ligjeve të reja dhe specifike që do të kundërshtojnë KO dhe institucione shtetërore të qëndrueshme me njerëz që janë të përshtatshëm për funksionet që kryejnë."³²

Projekti RISE-ALB, i financuar nga Ministria Italiane e Punëve të Jashtme, është një nga shembujt më të mirë sesi OShC-të mund të ndryshojnë kulturën, ekonominë dhe shoqërinë në luftën kundër krimit të organizuar në Evropë. Me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare Shqiptare të Pasurisë së Konfiskuar, projekti përdor pronën e konfiskuar në Shqipëri, bën ripërdorimin e pasurisë së fituar në mënyrë kriminale dhe e përdor atë për qëllime publike dhe shoqërore. Qëllimi i projektit është mundësia e shndërrimit shoqëror dhe publik të pasurisë së fituar përmes akteve kriminale. Partneri i tij, LIBERA, ndau përvojën italiane në trajnime dhe punëtori të organizuara për aktorë të ndryshëm në Shqipëri: përfaqësues të institucioneve kombëtare, anëtarë të OShC-ve dhe gjyqtarë.

Rrjetëzimi

Krijimi i një rrjeti që përfshin OShC-të, kriminologët nga komuniteti akademik dhe komuniteti lokal me fokus në hulumtimin e KO është një mekanizëm tjetër i rëndësishëm që përdoret për të luftuar KO, ku rrjetëzimi brenda shoqërisë civile - midis ekspertëve të grupeve të ekspertëve dhe organizatave të komunitetit është me rëndësi të veçantë. Ajo që del në pah në këtë kontekst është shkëmbimi i informacionit, përvojave dhe njohurive. Metoda e 'rrjetëzimit' përveç mbledhjes së pikëpamjeve të ndryshme mbi metodat dhe përvojat disiplinore shërben gjithashtu për të arritur qasjen gjithëpërfshirëse të lartpërmendur ndaj fenomenit të KO.

30 Fabian Zhilla (Ekspert për Krimin e Organizuar në GI-TOC), intervistë e kryer më 10 prill 2020

31 Uglješa Zvekić (Këshilltar i Lartë në GI-TOC, Romë), intervistë e kryer më 6 prill 2020.

32 Lucas Manjon (Përfaqësues i ALAS, Buenos Aires), intervistë e kryer më 29 prill 2020.

Në korrik 2018, Nisma Globale kundër Krimin të Organizuar Transnacional (GI-TOC) filloi Observatorin e Shoqërisë Civile për Krimin e Organizuar në Evropën Juglindore (SEE-Obs).³³ Pas krijimit të Observatorit, është krijuar një rrjet rajonal për të mbështetur shoqërinë civile përmes shkëmbimit të informacionit dhe aktiviteteve që synojnë përmirësimin e njohurive. Rrjeti mobilizon individë dhe grupe (nga organizatat joqeveritare, komuniteti akademik dhe mediat) për të punuar së bashku për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin dhe për të ndërtuar institucione të forta (Amerhauser, 2019).

Aleanca për Parandalimin e Krimin dhe Drejtësinë Penale bashkon një rrjet të gjerë të organizatave të shoqërisë civile që kontribuojnë në arritjen e sigurisë dhe drejtësisë për të gjithë.³⁴ Ajo siguron që shoqëria civile të njihet dhe dëgjohet në avancimin e luftës kundër krimin dhe agjendës së drejtësisë penale dhe në hartimin, zbatimin dhe matjen e rezultateve të politikave përkatëse kudo. Nën kujdesin e Aleancës, bashkëpunimi do të rritet, si dhe ekspertiza dhe vizioni i secilit prej anëtarëve në mënyrë që ata të mund të kontribuojnë në vlera dhe të mbështesin punën e organizatave përkatëse ndërkombëtare, veçanërisht UNODC. Aleanca inkurajon anëtarët e saj të luajnë një rol kyç në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, në veçanti Objektivin 16: "Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, përmes mundësisë të qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimin e institucioneve efikase, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet."

Përmes kultivimit të marrëdhënieve midis komponentëve të shoqërisë civile, dhe posaçërisht politikëbërësve dhe autoriteteve kombëtare, lidhja midis shoqërisë dhe shtetit forcohet, duke rezultuar në përpjekje të ndërsjella për të parandaluar dhe luftuar fenomenin e KO.

"Për shembull, gjatë viteve të fundit, ne [LIBERA] kemi përgatitur projekte për të rinjtë që gjykohen si të mitur. Projekti u ka mundësuar këtyre të rinjve që të gjykohen në një mënyrë tjetër, duke u dhënë atyre mundësinë të kenë një alternativë nga shkuarja në burg. Sidoqoftë, ne nuk e bëmë atë vetë; ne krijuam projektin së bashku me Ministrinë e Drejtësisë."³⁵

Praktika e mirë lidhet me forumin ndërkombëtar dhe organizimin e ngjarjeve anësore, ku OShC-të mund të përfshihen në tema të lidhura me KO, të diskutuara në takimet e përfaqësuesve të shtetit. Përpjekjet kryesore kundër KO në këtë nivel kanë për qëllim rishikimin e legjislacionit ndërkombëtar ose arritjen e statusit ligjor të OShC-ve në luftën kundër fenomenit të KO.

"Libera ka statusin e konsulentit të UNODC. Ne mund të marrim pjesë në shumicën e takimeve të KB në nivelin ndërkombëtar në Vjenë".³⁶

33 SEE-Obs synon të identifikojë, analizojë dhe hartojë trendet kriminale dhe ndikimin e tyre në rrjedhat e paligjshme, qeverisjen, zhvillimin, marrëdhëniet ndëretnike, sigurinë dhe sundimin e ligjit dhe t'i mbështesë ato në monitorimin e dinamikës kombëtare dhe tendencave të krimin të organizuar në një mjedis më të gjerë rajonal dhe ndërkombëtar. Selia e SEE-Obs është në Vjenë dhe ka mbështetjen e qeverive të Mbretërisë së Bashkuar, Norvegjisë, Gjermanisë, Holandës, Austrisë dhe Polonisë. Faqja zyrtare e internetit: <https://globalinitiative.net/the-civil-society-observatory-to-counter-organized-crime-in-south-eastern-europe/#:~:text=SEE%2DObs%20aims%20at%20identifying,and%20international%20organized%2Dcrime%20trends>

34 Aleanca bashkon një rrjet të gjerë të organizatave të shoqërisë civile që kontribuojnë në arritjen e sigurisë dhe drejtësisë për të gjithë. Faqja zyrtare e internetit: <https://crimealliance.org/>

35 Giulia Baruzzo (Zyrtare e Lartë në Departamentin Ndërkombëtar të LIBERA, Romë), intervistë e kryer më 16 prill 2020.

36 Po aty.

Përfaqësimi

Angazhimi për të azhurnuar ligjin ka rezultuar i dobishëm në luftën kundër KO, veçanërisht në mjediset me një “traditë të gjatë” të aktiviteteve të paligjshme të KO. Një nga shembujt më të mirë lidhet me LIBERA, aktivitetet e të cilës dhe mobilizimi i opinionit publik dhe komunitetit akademik çuan në miratimin e Ligjit të vitit 1996 mbi Përdorimin Shoqëror të Pasurisë së Konfiskuar. Masa pati efekt të përhapur dhe rezultoi në miratimin e ligjeve ose projekteve të ngjashme në shtete të tjera.

Ligji për përdorimin shoqëror të pasurisë së konfiskuar u miratua pas viteve të debateve intensive brenda dhe jashtë Parlamentit, në sajë të përfshirjes së drejtpërdrejtë të qindra e mijëra qytetarëve –për çka angazhohej LIBERA, e udhëhequr nga At Luigi Ciotti - i cili mbledhi një milion nënshkrime. Pas miratimit të tij, LIBERA ka treguar se ky ligj kompleks, i cili lejon ripërdorimin e pasurive kriminale për të mirën e shoqërisë, mund të jetë një mundësi e shkëlqyer për të gjithë. Ky ishte një nga kontributet më të rëndësishme të LIBERA-s. Miratimi i ligjit ishte me të vërtetë një sukses i madh, sepse kjo nënkuptonte që problemi i kahershëm se si të përdoret prona e konfiskuar u zgjidh me mjete inovative të tilla si rritja e përgjegjësisë sociale të komuniteteve duke krijuar vende pune për të rinjtë ose duke krijuar qendra bujqësore. Në vitin 2006, LIBERA filloi projektin Terra, në të cilin studentët punojnë në tokë të konfiskuar për prodhimin e ushqimit organik.

Një hap i rëndësishëm në forcimin e ndikimit të shoqërisë civile është mbajtja e presionit mbi autoritetet kombëtare. Përveç zhvillimit të legjitimitetit në terren përmes hulumtimit, zbulimit dhe luftimit të krimin të organizuar, OShC-të forcojnë aftësinë e tyre për të bërë presion mbi institucionet. Kjo është metoda më e zakonshme e zbatuar përmes kanaleve të ndryshme (media, internet, konferenca publike, veprime në rrugë, etj.) për të shprehur shqetësimin e komunitetit në lidhje me pasojat negative të aktiviteteve të KO.

4. KONKLUZION

Bazuar në studimin, mund të konkludojmë se natyra e ndryshueshme e KO, ku aktivitetet e dhunshme janë zëvendësuar nga ato më delikate, kërkon përfshirje më të madhe të shoqërisë civile, veçanërisht në WB6 si një rajon transit për aktivitete të paligjshme, i cili gjithashtu po përjeton rënie të demokracisë. OShC-të në shkallë të ndryshme mund të plotësojnë boshllëkun në kontrollin e krimit institucional përmes aktiviteteve parandaluese të shoqërisë civile të përqendruara në hulumtim, përfaqësim, mbrojtje, mbështetje dhe mobilizim të qytetarëve. Aktivitetet e OShC-ve janë të domosdoshme “për sa kohë që cilësia, kërkimi i së vërtetës përtej sensacionales, përkushtimi ndaj më të rrezikuarve midis nesh dhe ndjekja e ndryshimeve të qëndrueshme janë prioritet”.³⁷

Korniza legjislative në nivelin e KB dhe BE nuk e njeh plotësisht rëndësinë e shoqërisë civile në luftën kundër KO. Si rezultat, përpjekjet e shoqërisë civile për të ndërtuar ura midis palëve të interesuara publike dhe private dhe për të zbuluar dëmet e shkaktuara nga KO janë të sfiduara. Sidoqoftë, ka edhe sfida të brendshme për OShC-të. Shumica e tyre janë të specializuara ose të përqendruara në një fushë specifike të krimit të organizuar, të tilla si p.sh. trafikimi i qenieve njerëzore dhe varen nga situata në shtet, konteksti dhe disponueshmëria e fondeve të donatorëve.

Studimi identifikoi pesë metoda për zgjidhjen e çështjeve të KO nga këndvështrimi i shoqërisë civile. OShC-të mund të shqyrtojnë, rishikojnë ose hulumtojnë raste specifike, si dhe format e KO dhe reagimet institucionale ndaj tyre. Përveç kësaj, ato mund të ngritin vetëdijen e publikut dhe të edukojnë qytetarët për problemet e shkaktuara nga krimi i organizuar, ose të ndihmojnë/mbështesin individë dhe grupe që janë të cenuara ose në rrezik. Me rrjetëzimin e palëve të interesuara, me angazhimin për zgjidhje ose me mbajtjen e presionit të vazhdueshëm mbi institucione, OShC-të mund të jenë aktorë të ndryshimit në kulturë, ekonomi dhe shoqëri në luftën kundër krimit të organizuar.

37 Intervista e 4-të.

5. REKOMANDIME

Shoqëria civile

Qasja holistike ndaj KO. Është e rëndësishme që qytetarët të kuptojnë ndikimin e krimit të organizuar në shoqëritë e tyre - si nga ana konceptuale ashtu edhe nga ana holistike - dhe si këto krime janë të ndërlidhura. Të gjithë ato kontribuojnë në pasigurinë dhe përmbyshjen e shtetit ligjor. OShC-të që synojnë drejt krimit të organizuar mund të përmbushin këtë rol.

Kuptimi i kontekstit në të cilin ndodh KO. Është thelbësore që të ripërcaktohet koncepti i krimit të organizuar dhe konteksti në të cilin ai ka evoluar. Rrethana të ndryshme politike, ekonomike, ligjore dhe shoqërore mund të prodhojnë forma të ndryshme të krimit. Duke pasur parasysh që WB6 është kryesisht një rajon transit kur bëhet fjalë për KO, dhe duke pasur parasysh nivelin e korrupsionit, aktivitetet e OShC-ve duhet të jenë në përputhje me këto çështje.

Roli më aktiv dhe më urgjent i OShC-ve. Shoqëria civile duhet të jetë më aktive dhe të bëjë më shumë presion mbi qeveritë. Veçanërisht interesante janë qeveritë që favorizojnë OShC-të, pasi ato mund të përdorin kanale diplomatike dhe kështu të angazhohen dhe promovojnë rolin e OShC-ve në luftimin e fenomenit të KO midis qeverive që nuk ndajnë mendimin e tyre.

Orientimi drejt komunitetit lokal. Në nivelin e komunitetit, OShC-të duhet të përdorin lidhjet e tyre lokale për të krijuar mesazhe që prekin banorët (siç janë komunitetet kufitare) që janë prekur më shumë nga krimi i organizuar. Në atë kontekst, **synimi kah** të rinjtë dhe grupet e tjera të prekshme të ekspozuar ndaj aktiviteteve të paligjshme të KO është një nga masat më të rëndësishme parandaluese.

Bashkëpunimi me bashkësitë fetare. Në varësi të nivelit të angazhimit të qytetarëve ndaj bashkësive të ndryshme fetare, ata mund të veprojnë si një medium shumë i rëndësishëm për të ndikuar në shoqëri. Prandaj, bashkëpunimi i mundshëm midis OShC-ve dhe bashkësive fetare nuk duhet të neglizhohet.

Bashkëpunimi për të ardhme të qëndrueshme. OShC-të duhet të krijojnë rrjete me të gjithë aktorët (përfshirë politikanët) që mund të ndihmojnë në arritjen e konsensusit dhe lëvizjen drejt ndryshimeve të qëndrueshme që do të ndërmerren në nivelet lokale dhe kombëtare.

Autoritetet e pushtetit kombëtar

Formalizimi i rolit të OShC-ve në luftën kundër KO. OShC-të duhet të luajnë rol qendror në monitorimin dhe vlerësimin e përpjekjeve të WB6 për të luftuar KO. Si hap i parë, ky mekanizëm kërkon një ndryshim në rregulloret dhe gatishmërinë e shtetit për të njohur potencialin e OShC-ve dhe për të kultivuar kapacitetet e tyre në luftimin e fenomenit të KO.

Bashkëpunimi rajonal në koordinimin e mbledhjes, analizës dhe shkëmbimit të të dhënave për KO. Praktika e mirë mund të shërbejë si model i përfaqësimit në juridiksione të tjera. Rezultati i këtij aktiviteti mund të jetë një kuptim i ndërsjellë dhe më i mirë i KO, i cili do të ndihmonte agjencitë e zbatimit të ligjit dhe politikëbërësit në krijimin e politikave dhe strategjive më të mira për të luftuar krimin e organizuar.

Rrjetëzimi. Mbledhja e të gjithë aktorëve në luftën kundër KO - të tillë si OShC-të, akademikët, gazetarët, politikëbërësit dhe vendimmarrësit - duket se është një nga metodat më të rëndësishme. Kultivimi i marrëdhënies midis komponentëve të shoqërisë civile, veçanërisht politikëbërësve dhe zyrtarëve të zbatimit të ligjit dhe prokurorisë, forcon lidhjen midis shoqërisë dhe shtetit, duke u mundësuar atyre që të bashkojnë forcat në parandalimin dhe luftimin e fenomenit të KO. Për më tepër, kur OShC-të janë të lidhura me agjendat dhe iniciativat ekzistuese kombëtare të cilat merren me angazhimin për një mjedis më të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile në përgjithësi, roli i tyre është i formalizuar dhe ata janë në gjendje të ndikojnë në të gjitha politikat relevante.

Komuniteti ndërkombëtar

Përfshirja legjislative e rolit të OShC-ve. OShC-të duhet të njihen zyrtarisht si aktorë të nevojshëm në luftën kundër aktiviteteve të KO, duke fituar statusin ligjor në konventat e KB dhe ligjet e tjera.

Ndërtimi i kapaciteteve. Forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile në WB6 është hap themelor në mbajtjen e presionit mbi autoritetet dhe ushtrimin e ndikimit të rëndësishëm në zonën e WB6.

Përafrimi i komunitetit akademik. Në WB6, aftësia hulumtuese në fushën e kriminologjisë dhe interesi i hulumtuesve akademikë në fushën e krimit të organizuar janë përgjithësisht të dobët. Disa institucione kryesore hulumtuese po zbatojnë projekte në rajon, por studiuesit e trajnuar kriminologjik janë kryesisht të jashtëm. Përfshirja më e madhe e komunitetit akademik dhe universiteteve (veçanërisht për shkak të autonomisë dhe ndikimit të tyre)³⁸ është e një rëndësie të madhe. Inkurajimi i kësaj lidhjeje e vë në plan të parë shkëmbimin e informatave, përvojave dhe praktikave të njohurive.

Sektori privat

Përfshirja e ndërmarrjeve publike dhe private. Partneritetet publike-private dhe inkurajimi i bizneseve për të punuar me OShC-të përmes iniciativave të ndryshme të përfaqësimit mund të jenë shembull shumë i frytshëm i luftës kundër aktiviteteve të paligjshme të KO. Me fjalë të tjera, kjo formë e bashkëpunimit pranon që shtetet nuk mund të luftojnë vetë format e ndryshme të KO, ndërsa interesi i kompanive është të zvogëlojnë pasojat e KO dhe t'i eliminojnë ato nga tregu i lirë, duke lënë hapësirë për aktivitetet e tyre ligjore. Prandaj, angazhimi i ndërsjellë do të sillte përfitime reciproke për të gjitha palët e përfshira.

38 Uglješa Zvekić (Këshilltar i Lartë në GI-TOC, Romë), intervistë e kryer më 6 prill 2020.

BIBLIOGRAFIA

- Amerhauser, K. (2019). "How Can Civil Society Counter Organized Crime in the Western Balkans? Insights and Recommendations from Roundtable Engagements with Civil Society Actors Across the Region", available at: <https://globalinitiative.net/civil-society-western-balkans/> (accessed 15 June 2020)
- Andreas, P. (2004), "The Clandestine Political Economy of War and Peace in Bosnia", *International Studies Quarterly*, Vol. 48 No. 1, pp. 29-51.
- Balkan Civil Society Development Network. (2019), "Growing Pressure on Civil Society and What To Do About It: Regional Report on the Trends in the Enabling Environment for Civil Society Development in Enlargement Countries 2017/2018", available at: <http://www.balkanncsd.net/novo/wp-content/uploads/2019/11/BCSDN-growing-pressure-Publication.pdf> (accessed 15 June 2020)
- Buscaglia, E. and Van Dijk, J. (2003), "Controlling organized crime and corruption in the public sector", *Forum on Crime and Society*, Vol. 3 No. 1-2, pp. 3-35.
- Burkett, E. (2009), "Mafia-Free Food?", available at: <https://www.delish.com/food/news/a37856/mafia-free-italian-food-labels/> (accessed 15 June 2020)
- Civil Hub Against Organized Crime in Europe. (2019), "Political Agenda of the European Network CHANCE", available at: https://www.libera.it/documenti/schede/chance_political_agenda_2019_eng.pdf (accessed 15 June 2020)
- Council Framework Decision 2008/841/JHA of 24 October 2008 On the Fight Against Organized Crime, available at: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32008F0841> (accessed 15 June 2020)
- Dobovšek, B. (2006), "Transnational Organized Crime in the Western Balkans", available at: http://www.humsec.eu/cms/fileadmin/user_upload/humsec/Working_Paper_Series/Working_Paper_Dobovsek.pdf (accessed 15 June 2020)
- Finckenauer, J. (2005), "Problems of Definition: What is Organized Crime?", *Trends in Organized Crime*, Vol. 8 No. 3, pp. 63-83.
- Glenny, M. (2012), *The Balkans, 1804-2012: Nationalism, War and the Great Powers*, GRANTA Book, London.
- Global Initiative Against Transnational Organized Crime. (2019), "Hotspots of Organized Crime in the Western Balkans: Local Vulnerabilities in a Regional Context", available at: <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2019/05/Hotspots-Report-English-13Jun1110-Web.pdf> (accessed 15 June 2020)
- Global Initiative Against Transnational Organized Crime. (2019), "The Essential Role of Civil Society in The UNTOC and UNCAC Review Processes", available at: <https://globalinitiative.net/the-essential-role-of-civil-society-in-the-untoc-and-uncac-review-processes/> (accessed 15 June 2020)
- Picarelli, J. (2013), "Transnational organized crime", William, P. (Ed.), *Security Studies*, Routledge, Abingdon, pp. 477-491.
- Sanfey, P. and Milatović, J. (2018), *The Western Balkans In Transition: Diagnosing the Constraints on The Path to A Sustainable Market Economy*, European Bank for Reconstruction and Development, London.

- Scarabelli, D. (2013), "Anti-mafia in Europe", available at: <https://readingitaly.wordpress.com/2013/11/04/mafias-memory/> (accessed 15 June 2020)
- Southeast Europe Law Enforcement Centre. (2019), "Report on Drug Seizures in Southeast Europe", available at: <https://www.selec.org/wp-content/uploads/2019/12/SELEC-Report-on-Drug-Seizures-2019-Public-version.pdf> (accessed 19 May 2020)
- United Nations Office on Drugs and Crime. (2009), "Organized Crime and Trafficking in Eastern Africa", available at: https://www.unodc.org/res/cld/bibliography/transnational-organized-crime-in-eastern-africa_-a-threat-assessment_html/TOC_East_Africa_2013.pdf (accessed 15 June 2020)
- United Nations Office on Drugs and Crime. (2013), "Business, Corruption, and Crime in the Western Balkans: The Impact of Bribery and Other Crime on Private Enterprise", available at: https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/corruption/Western_balkans_business_corruption_web.pdf (accessed 15 June 2020)
- United Nations Office on Drugs and Crime. (2014), "The Illicit Drug Trade Through South-Eastern Europe", available at: https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Studies/Illicit_DT_through_SEE_REPORT_2014_web.pdf (accessed 15 June 2020)
- United Nations Office on Drugs and Crime. (2015), "Drug Money: the illicit proceeds of opiates trafficked on the Balkan route", available at: https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Studies/IFF_report_2015_final_web.pdf (accessed 15 June 2020)
- United Nations Office on Drugs and Crime. (2017), "Measuring Organized Crime: Assessment of data in the Western Balkans", available at: https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Macro/Research_brief.pdf (accessed 15 June 2020)
- United Nations. (2004), "Convention Against Corruption", available at: https://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/Convention/08-50026_E.pdf (accessed 15 June 2020)
- United Nations. (2004), "Convention Against Transnational Organized Crime and the Protocols Thereto", available at: https://www.unodc.org/documents/middleeastandnorthafrica/organised-crime/UNITED_NATIONS_CONVENTION_AGAINST_TRANSNATIONAL_ORGANIZED_CRIME_AND_THE_PROTOCOLS_THERETO.pdf (accessed 15 June 2020)
- Van Dijk, J. (2011), "Transnational Organized Crime, Civil Society and Victim Empowerment", Rianne L. and Van Dijk, J. (Eds.), *The New Faces of Victimhood: Globalization, Transnational Crimes and Victim Rights*, Springer, Dordrecht, pp. 99-125.
- Zhilla, F. and Besfort L. (2015), "Organized Crime Threat Assessment in Albania", https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2018/02/Threat_Assessment_of_Albanian_Organised.pdf (accessed 19 May 2020)



www.bezbednost.org